

GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës: PAKR 907 / 12

Data: 30 prill 2013

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati si kryetare e kolegjit dhe si gjyqtare raportuese, si dhe gjyqtarët Fillim Skoro e Xhevdet Abazi si anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore të EULEX-it Beti Hohler, si procesmbajtëse,

Në procedurën penale kundër të akuzuarve:

- 1. SH. M.**, i lindur më ... në ..., ..., ..., me kombësi shqiptar, me vendbanim në ..., emri i të atit ..., emri i së ëmës ..., mekanik, i martuar, baba i fëmijëve, ka të kryer tetë (8) vjet të shkollimit fillor, ish ..., dhe
- 2. B. T. (i njohur si ...)**, i lindur më ... në ..., me kombësi shqiptar, emri i të atit ..., emri i së ëmës ..., i pamartuar, ka të kryer shkollimin e mesëm, me gjendje të dobët ekonomike, aktualisht me vendbanim në fshatin ..., në Kosovë;

Të dy të akuzuar për veprat penale në vazhdim: rrëmbim i dëshmitarit FY, sipas nenit 64 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste të Serbisë (Gazeta Zyrtare e RS të Serbisë nr. 26 / 77, më vonë e ndryshuar, më tej në tekst si LP i RSS-së), lidhur me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 44 / 1976, më tej në tekst si KP i RSFJ-së) (Pika C e aktakuzës së ndryshuar);

Duke e pasur parasysh se të akuzuarit janë shpallur fajtorë për veprat penale të rrëmbimit (Sh. M., B. T.) dhe të detyrimit në tentativë (Sh. M.), për të cilat gjykatat po ashtu tashmë kishin përcaktuar dënimin individual të formës së prerë (aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Gjilanit nr. P 199 / 2003 i datës 25.06.2004 i cili është vërtetuar (në këtë pjesë) me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës nr. AP 470 / 2004 të datës 27.03.2007).

Duke vendosur ankesat e mëposhtme të paraqitura ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit nr. P 118/11 të datës 02.12.2011:

- **Ankesa e avokatit mbrojtës Nike Shala në emër të të akuzuarit Sh. M., e parashtruar më datën 27.12.2011,**
- **Ankesa e avokatit mbrojtës Masar Morina në emër të të akuzuarit B. T., e parashtruar më datën 20.12.2011;**

Pas rishikimit të mendimit të prokurorit të apelit të shtetit nr. PPA 34 / 12 të datës 22.02.2012 dhe të parashtruar më datën 23.02.2012;

*Pas mbajtjes së seancës publike më 30.04.2013 në praninë e të akuzuarve **Sh. M.** dhe **B. T.**, avokatëve të tyre mbrojtës Masar Morina dhe Nike Shala si dhe të prokurorit të apelit të shtetit Xhevdet Bislimi;*

Pas mbajtjes së këshillimit dhe votimit më 30.04.2013,

Në bazë të nenit 376 dhe nenit 381 et seq të Ligjit mbi Procedurën Penale (Gazeta Zyrtare Nr. 26 / 86, RSFJ, më tej në tekst LPP)

Merr këtë

A K T G J Y K I M

Ankesa e avokatit mbrojtës Nike Shala në emër të të akuzuarit Sh. M., e parashtruar më datën 27.12.2011 dhe ankesa e avokatit mbrojtës Masar Morina në emër të të akuzuarit B. T., e parashtruar më datën 20.12.2011, të dyja kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit nr. P 118/11 të datës 02.12.2011, hedhen poshtë si të palejueshme në pjesën ku kundërshtojnë dënimin dhe shqiptimin e dënimeve individuale ndaj të akuzuarve në bazë të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit nr. P 199 / 2003 të datës 25.06.2004 i cili është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme AP 470 / 2004 të datës 27.03.2007.

Në pjesën tjetër, ankesat e mbrojtjes refuzohen si të pabazuara.

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Gjilanit nr. P 118 / 11 i datës 02.12.2011 vërtetohet.

ARSYETIM

1. Gjykata e Apelit në fillim duhet të adresojë çështjen e ligjit të zbatueshëm në këtë lëndë dhe të diskutojë historinë e lëndës lidhur me të dy ankuesit (**Sh. M., B. T.**). Për shkak të historisë komplekse procedurale e cila ndikon në procedurën e tanishme, Gjykata e Apelit do ta adresojë këtë çështje më hollësisht.

2. Më pastaj Gjykata e Apelit do ta trajtojë kompetencën e gjykatës, pranueshmërinë e ankesave dhe meritat e tyre.

I. Ligji i zbatueshëm i procedurës në këtë lëndë

3. Aktakuza në këtë lëndë është ngritur pranë Gjykatës së Qarkut të Gjilanit më 09.12.2003 dhe është ndryshuar më 21.01.2004, para hyrjes në fuqi të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, i cili më vonë njihet si Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), i cili ka qenë në fuqi nga data 06.04.2004 deri më datën 31.12.2012.

4. KPPK-ja ka pasur në vete një dispozitë kalimtare në nenin 550, sipas të cilës të gjitha procedurat penale në të cilat aktakuza ishte ngritur para hyrjes në fuqi të KPPK-së dhe nuk kishin përfunduar deri më datën 06.04.2004, do të vazhdoheshin sipas dispozitave të ligjit të mëhershëm të zbatueshëm (Ligji mbi procedurën penale i vitit 1986) deri sa aktgjykimi i marrë në shqyrtimin gjyqësor të merr formën e prerë.

5. Edhe pse një pjesë e procedurës ndaj të akuzuarve në këtë lëndë ka marrë formën e prerë, aktakuza e parashtruar më datën 09.12.2003 dhe e ndryshuar më 21.01.2004, ka mbetur aktakuzë në pritje lidhur me veprën penale të *rrëmbimit* të dëshmitarit FY dhe caktimin e dënimit unik. Rrjedhimisht, shqyrtimi gjyqësor në këtë lëndë është mbajtur në përputhje me dispozitat e Ligjit mbi procedurën penale (Gazeta Zyrtare nr. 26 / 86).

6. Më 01.01.2013 në Kosovë ka hyrë në fuqi ligji i ri i procedurës – Kodi i Procedurës Penale, ligji penal nr. 04 / L - 123. Ky kod i ri ka shfuqizuar KPPK-në. Kodi i ri zbatohet në të gjitha procedurat penale në vazhdim e sipër të nisura para hyrjes së tij në fuqi, përveç në rastet kur shqyrtimi gjyqësor ka filluar para datës 01.01.2013 ose kur një lëndë është kthyer në rigjykim (shih po ashtu mendimin juridik të Gjykatës Supreme nr. 56 / 2013, të miratuar në seancën e përgjithshme të datës 23 janar 2013).

7. Në rastin në fjalë ligji i zbatueshëm procedural sipas ligjit në fuqi të KPP-së do të ishte KPPK-ja, ngase shqyrtimi gjyqësor në këtë lëndë ka filluar para hyrjes në fuqi të KPP-së. KPPK-ja përmes nenit 550, siç shihet, megjithatë derogohet para Ligjit mbi procedurën penale të vitit 1986, prandaj sipas nenit 550 të KPPK-së, ligji i aplikueshëm i procedurës në këtë rast mbetet Ligji mbi procedurën penale i vitit 1986 (më tej në tekst LPP). Gjykata e Apelit rrjedhimisht procedurën e ka zhvilluar në përputhje me LPP-në

II. Procedura e gjertanishme e lëndës

8. Aktakuza ndaj të dy të akuzuarve dhe ndaj tre të pandehurve të tjerë (Xh. M., F. Q., J. A.) është ngritur për vepra të shumëfishta penale në vitin 2003 (Aktakuza nr.. PP 107 / 03 e datës 09.12.2003 dhe më vonë është ndryshuar më datën 21.01.2004).

9. Gjykimi fillestar i kësaj lënde është mbajtur në mes të datave 10.02.2004 dhe 25.06.2004. Aktgjykimi i parë në këtë lëndë është marrë më datën 25.06.2004 – Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Gjilanit nr. P 199/2003.

Me këtë aktgjykim (në pjesën përkatëse):

- Të akuzuarit **Sh. M.** dhe **B. T.** janë shpallur fajtorë për *rrëmbimin* e dëshmitarëve 3 dhe 4 dhe të dëshmitarit FY sipas nenit 64 par. (1), (2) dhe (4) të LP të RSS-së, lidhur me nenin 22 të KP të RSFJ-së;
- I akuzuari **Sh. M.** është shpallur fajtor për *detyrim në tentativë* sipas nenit 180 të LP të RSS-së, lidhur me nenet 19 dhe 22 të KP të RSFJ-së;
- I akuzuari **Sh. M.** është shpallur fajtor për *rrëmbimin* e dëshmitarit AK sipas nenit 64 par. (1) dhe (2) të LP të RSS-së, lidhur me nenin 22 të KP të RSFJ-së;
- I akuzuari **Sh. M.** është shfajësuar për *posedim të paautorizuar të armëve* (24.04.2002) në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001 / 7, nenet 8.2. dhe 8.3.;
- Të akuzuarit **Sh. M.** dhe **B. T.** janë shfajësuar për *posedim të paautorizuar të armëve* (24.04.2002) në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001 / 7, nenet 8.2. dhe 8.3
- Të akuzuarit **Sh. M.** , **B. T.** janë shfajësuar për veprën penale *bashkim kriminal (krim i organizuar)* sipas nenit 227 të LP të RSS-së.

10. Trupi gjykues ka dënuar **Sh. M.** me dënim prej 8 vjet burgim për secilën pikë të *rrëmbimit* dhe me dënim prej 2 vjet burgim për pikën e *detyrimit në tentativë*. Trupi gjykues ka caktuar dënimin unik prej 12 vjet burgim.

11. Trupi gjykues ka dënuar **B. T.** me dënim prej 5 vjet burgim për secilën pikë të *rrëmbimit*. Dënimi unik për këtë të akuzuar është caktuar të jetë 7 vjet burgim.

12. Të akuzuarit kanë ushtruar ankesa ndaj aktgjykimit të datës 25.06.2004 ndërsa më 27.03.2007 Gjykata Supreme e Kosovës ka marrë aktgjykimin e saj nr. AP 470 / 2004.¹ Gjykata Supreme ka anuluar në mënyrë të pjesshme aktgjykimin nr. P 199 / 2003 të datës 25.06.2004 lidhur me rrëmbimin e dëshmitarit FY dhe në këtë pjesë ka kthyer lëndën prapa në rigjykim. Në pjesën tjetër Gjykata Supreme ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Gjilanit të datës 25.06.2004. Pjesët e vërtetuara të aktgjykimit kanë qenë në mënyrë specifike:

a) Në rastin e **Sh. M.** gjetja fajtor dhe dënimet prej 8 vjet burgim për *rrëmbimin* e dëshmitarëve 3 dhe 4 dhe AK dhe gjetja fajtor dhe dënimi prej 2 vjet burgim për *detyrim në tentativë* dhe

b) në rastin e **B. T.** gjetja fajtor dhe dënimet prej 5 vjet burgim për *rrëmbimin* e dëshmitarëve 3 dhe 4.

c) Gjykata Supreme po ashtu ka vërtetuar aktgjykimin me të cilin kjo e fundit ka shfajësuar të akuzuarit për veprat penale.

13. Gjykata e Apelit në mënyrë specifike vëren se pjesët e mësipërme të aktgjykimit nr. P 199 / 2003 të datës 25.06.2004 kanë marrë formën e prerë më datën 27.03.2007 (d.m.th. të gjitha dënimet përveç pikës e cila ka të bëjë me rrëmbimin e dëshmitarit FY, dënimet e veçanta, dhe shfajësimin e të akuzuarve për pikat 5, 6 dhe 7).

14. Për shkak se Gjykata Supreme ka anuluar një pikë të dënimit (e cila lidhet me rrëmbimin e dëshmitarit FY), Gjykata Supreme po ashtu ka anuluar dënimet unike të caktuara për të akuzuarit

¹ Gjykata Supreme më datën 10.03.2010 ka lëshuar korigjimin e aktgjykimit AP 470 / 2004 të marrë më 27.03.2007, në të cilin ka korigjuar në gabim material në dispozitiv. Për këtë arsye aktgjykimi i korigjuar i datës 10.03.2010 duhet të lexohet së bashku me aktgjykimin e datës 27.03.2007.

dhe ka urdhëruar gjykatën e shkallës së parë të vendosë pikën e kthyer (rrëmbimin e dëshmitarit FY) dhe pastaj të vërtetojë dhe të caktojë dënimin e ri unik.

15. Rigjykimi (i parë) në bazë të vendimit të Gjykatës Supreme është mbajtur më datat 01.09.2010 dhe 05.10.2010, tash me numrin P 181 / 07. Gjatë rigjyimit, prokurori më datën 04.10.2010 ka tërhequr akuzën penale lidhur me rrëmbimin e dëshmitarit FY. Gjykata e Qarkut të Gjilanit pas kësaj ka shpallur aktgjykimin në këtë lëndë më datën 05.10.2010, duke refuzuar akuzën tjetër penale ndaj të dy të akuzuarve. Trupi gjykues ka vazhduar me llogaritjen e dënimeve unike në përputhje me udhëzimin e Gjykatës Supreme për veprat tjera penale për të cilat gjetja fajtor dhe dënimi i veçantë i caktuar kishin marrë formën e prerë më 27 mars 2007. Trupi gjykues ka caktuar dënimin unik prej 10 vjet e 6 muaj burgim për **Sh. M.** dhe dënimin unik prej 6 vjet e 9 muaj burgim për **B. T.**

16. Të dy të akuzuarit kanë ushtruar ankesa ndaj këtij aktgjykimi. Gjykata Supreme e Kosovës me aktvendimin e saj nr. AP 351 / 2010 ka anuluar aktgjykimin nr. P 181 / 07, për shkak se dispozitivi i aktgjyimit nuk kishte përfshirë përshkrimin faktik të akuzës së refuzuar dhe nuk përmbante referimin tek dënimet e veçanta të cilat ishin mbledhur në dënimin unik për secilin të akuzuar dhe arsyetimin se në çfarë mënyre trupi gjykues kishte llogaritur dënimet e caktuara unike. Lënda u kthye në rigjykim në Gjykatën e Qarkut.

17. Rigjykimi i dytë, tash me numrin P 118 / 11 ka filluar më 2 shtator 2011 dhe ka rezultuar me aktgjykimin nr. P 118/11 të datës 02.12.2011, i cili tash është duke u shqyrtuar para Gjykatës së Apelit (më tej në tekst: aktgjykimi i kundërshtuar).

18. Trupi gjykues përmes aktgjyimit të kundërshtuar ka refuzuar akuzën penale lidhur me rrëmbimin e dëshmitarit FY, kundër të akuzuarve **Sh. M.** dhe **B. T.** Prokurori tashmë kishte tërhequr akuzën më 04.10.2010 dhe tërheqjen e saj e kishte konfirmuar gjatë seancës gjyqësore më 25.10.2011 dhe më 02.12.2011. Më pastaj, trupi gjykues kishte shqiptuar dënimet unike për të akuzuarin në përputhje me udhëzimin e Gjykatës Supreme për veprat e tjera për të cilat gjetja fajtor dhe dënimet e veçanta kishin marrë formën e prerë më 27.03.2007. Trupi gjykues kishte dënuar **Sh. M.** me dënimin unik prej 9 vjet burgim në bazë të nenit 48, par. (2), nënpar. 3) të KP të RSFJ-së. Dënimi unik është llogaritur në bazë të dënimeve të veçanta të caktuara përmes aktgjyimit të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit nr. P 199 / 2003 të datës 25.06.2004 i cili ka marrë

formën e prerë – në pjesët e gjetjes fajtor dhe dënimit prej 8 vjet burgim për veprën penale të rrëmbimit të dëshmitarëve 3 dhe 4, në gjetjen fajtor dhe dënimin prej 8 vjet burgim për veprën penale të rrëmbimit të palës së dëmtuar / dëshmitarit AK më 8 shtator 2001, në gjetjen fajtor dhe dënimin prej 2 vjet burgim për veprën penale *detyrim në tentativë* i dëshmitarit 1 më 24 prill 2002 – përmes aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. AP 470 / 2004 të datës 27.03.2007.

19. Trupi gjykues ka dënuar **B. T.** me dënim unik prej 6 vjet e 9 muaj burgim në bazë të nenit 48, par. (2), nënpar. 3) të KP të RSFJ-së. Dënimi unik është llogaritur në bazë të dënimeve të veçanta të caktuara përmes aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit nr. P 199 / 2003 të datës 25.06.2004 i cili ka marrë formën e prerë – në pjesët e gjetjes fajtor dhe dënimit prej 5 vjet burgim për veprën penale të rrëmbimit të dëshmitarëve 3 dhe 4 – përmes aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. AP 470 / 2004 të datës 27.03.2007.

20. Koha e kaluar në paraburgim lidhur me pjesët e përmendura më lart të aktgjykimit të cilat kanë marrë formën e prerë është llogaritur në dënimin unik për të dy të akuzuarit.

21. Aktgjykimi i arsyetuar u është dorëzuar të akuzuarve më 19.12.2011, përkatësisht më 20.12.2011.

22. Avokatët mbrojtës të të dy të akuzuarve kanë ushtruar ankesa ndaj aktgjykimit të kundërshtuar.

23. Gjykata e Apelit ka mbajtur seancën publike për lëndën më datën 30 prill 2013 në përputhje me nenin 374 të LPP-së. Të gjithë të pandehurit, avokatët e tyre mbrojtës dhe prokurori i apelit i shtetit janë ftuar në mënyrë të rregullt në seancë si dhe të gjithë kanë marrë pjesë në të.

II. Parashtrës të palëve

II.1. Ankesa e avokatit mbrojtës Nikë Shala

24. Avokati mbrojtës në ankesën e parashtruar pretendon se ka pasur vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin. I njëjti propozon ndryshimin e aktgjykimit të kundërshtuar apo kthimin e lëndës në rigjykim.

25. Avokati mbrojtës pohon se gjendja faktike u bazua në prova jo relevante, nuk ka prova për të mbështetur se i akuzuari **Sh. M.** ishte kryerës i veprave penale për të cilat ai u shpall fajtor dhe u dënua. Ai shtjellon se i akuzuari nuk kishte dashje të kryente ndonjë veprë penale dhe në mungesë të dashjes nuk ka as veprë penale. Më tej i akuzuari nuk kanë pasur ndonjë përfitim material. Aktgjykimi bazohet në pretendime e jo në fakte të provuara. Ai argumenton se gjykata e shkallës së parë shkeli ligjin penal sepse në vend që të liroj të akuzuarin, gjykata shpalli aktgjykimin e dënimit dhe e dënoi për një veprë të cilën i akuzuari nuk e ka kryer. Pastaj ai argumenton se dënimi unik nuk ka bazë ligjore, vendimi mbi dënimin nuk është adresuar aspak nga gjykata dhe se ndëshkimi është i pajustificuar.

II.2. Ankesa e avokatit mbrojtës Masar Morina

26. Avokati mbrojtës Morina pohon për shkelje të dispozitave të procedurës penale, shkelje të dispozitave të ligjit të aplikueshëm penal, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si edhe e kundërshton dënimin e shqiptuar. Ai propozon që aktgjykimi i kundërshtuar të priset dhe i akuzuari të lirohet nga përgjegjësia penale ose lënda të kthehet mbrapa në rigjykim ose të shqiptohet një dënim më i butë.

27. Avokati mbrojtës deklaron se dispozitivi i aktgjyimit të kundërshtuar dhe arsyetimi janë në kundërtënie, në dispozitiv nuk ka përshkrim të veprave për të cilat i akuzuari është shpallur fajtor dhe është dënuar. Ai shtjellon pikën një të aktakuzës e cila përmban akuzën lidhur me dëshmitarin 3 dhe 4. Ai po ashtu ngrit çështjen e zbatimit të ligjit më të favorshëm duke deklaruar se aplikimi i KPK-së do të ishte më i favorshëm sesa aplikimi i LP RSS sepse për veprën penale të *Rrëmbimit* ky i fundit parasheh 8 vjet burgim (neni 64 i LP RSS) përderisa neni 159 i KPK-së parasheh vetëm 5 vjet burgim. Ai më tej pohon se gjendja faktike është vërtetuar gabimisht me shpalljen e të akuzuarit fajtor për 2 pika të veprave penale lidhur me “personat” 3 dhe 4. Ai shton se dënimi është kundërtënës dhe jo i bazuar.

II.3 Përgjigja e prokurorit

28. Prokurori në lëndë nuk ka parashtruar përgjigje në ankesa.

II.4. Mendimi i prokurorit të shtetit të apelit

29. Prokurori i shtetit i apelit, Jusuf Mejzini në mendimin e tij të datës 22.02.2012 dhe të parashtruar më 23.02.2012 propozon që ankesat e mbrojtjes të refuzohen si të pabazuara dhe aktgjykimi nr. P 118/11 i GjQ në Gjilan të vërtetohet.

30. Prokurori i shtetit i apelit thekson se aktgjykimi në lëndë i nxjerr më 25.06.2004 ishte i formës së prerë për të gjitha veprat penale me përjashtim të veprës penale të *Rrëmbim* të dëshmitarit FY. Prandaj ankesat të cilat kundërshtojnë këto dënime janë të papranueshme.

31. Lidhur me dënimet unike, Gjykata e Qarkut në mënyrë korrekte shqyrtoi dhe vlerësoi rrethanat për shqiptimin e dënimit unik sipas dënimeve të veçanta të përcaktuara përfundimisht me aktgjykimin e datës 25.06.2004. Ankesat e mbrojtjes nuk vënë në pah ndonjë rrethanë lehtësuese të neglizhuar e një rrethanë e tillë as sipas detyrës zyrtare nuk ekziston. Në këtë aspekt pretendimet në ankesa prandaj janë të pabazuara.

III. Gjetjet e Gjykatës së Apelit

III.1. Kompetenca e Gjykatës së Apelit

32. Gjykata e Apelit është gjykatë kompetente për të vendosur për ankesën në pajtueshmëri me nenet 17 dhe 18 të Ligjit mbi Gjykatat (Ligji nr. 03/L-199). Lënda ishte në pritje në Gjykatën Supreme më 31.12.2012 si lëndë e shkallës së dytë dhe prandaj, me nenin 39 paragrafin (1) të Ligjit mbi Gjykatat, nga data 01.01.2013 është e trajtuar si lëndë në pritje në Gjykatën e Apelit.

33. Kolegji i Gjykatës së Apelit është formuar në përputhshmëri me nenin 19 paragrafi (1) të Ligjit mbi Gjykatat dhe nenin 3 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhja e lëndëve dhe caktimi i lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03/L-053). Sipas vendimit të kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it nr. 2013.OPEJ.0239-001 të datës 22.05.2013, të marr në përputhshmëri me nenin 3.7. të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhja e lëndëve dhe caktimi i lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, kolegji ishte i përbërë prej një gjyqtari të EULEX-it dhe dy gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit të Kosovës.

III.2. Pranueshmëria e ankesës

34. Aktgjykimi i kundërshtuar u shpall më 02.12.2011. Aktgjykimi me shkrim i është dërguar **Sh. M.** më datën 19.12.2011 dhe **B. T.** më 21.12.2011. Të dy avokatëve mbrojtës u është dërguar aktgjykimi më 19.12.2011.

35. Neni 359 paragrafi (1) i LPP-së parasheh 15 ditë për të ushtruar ankesë kundër aktgjykimit. Ankesat janë ushtruar më 20.12.2012 në emër të të akuzuarit **B. T.** respektivisht më 27.12.2012 në emër të të akuzuarit **Sh. M.**, pra në kohë sipas dispozitës së lartë përmendur.

36. Gjykata e Apelit më tej ka konfirmuar se ankesat janë ushtruar nga personat e autorizuar dhe në përputhshmëri me nenin 362 paragrafi (1) të LPP-së.

III.3. Gjetjet mbi meritat

37. Gjykata e Apelit i referohet historisë procedurale komplekse në lëndë, sikurse në mënyrë të hollësishme është sqaruar në kreun I.

38. Gjykata e Apelit vëren se trupi gjykues në rigjykimin e fundit, ka pasur para vetes një detyrë të dyfishtë: (a) të lëshoj aktgjykimin lidhur me pikën e mbetur e cila nuk është vendosur në formë të prerë – rrëmbimin e dëshmitarit FY dhe (b) pas lëshimit të aktgjykimit mbi atë pikë (çfarëdo që ajo ka mundur të jetë) të përcaktoj dhe shqiptoj dënime unike për të dy të akuzuarit duke pasur parasysh gjetjen fajtor dhe dënimet e veçanta të shqiptuara me aktgjykimin e datës 25.06.2004 të cilat kanë marrë formën e prerë përmes aktgjykimit të Gjykatës Supreme AP 470/2004 të datës 27.03.2007.

39. Gjykata e Apelit përsëri thekson se gjetja fajtor dhe dënimet individuale të përcaktuara kanë marrë formën e prerë më 27.03.2007. Trupi gjykues nuk ka pasur bazë ligjore të bëjë ndonjë vlerësim lidhur me fajësinë e të pandehurve e as të dënimeve të veçanta të shqiptuara. Këto gjetje janë vërtetuara në vitin 2007 në formë të prerë nga Gjykata Supreme.

40. Gjykata e Apelit vëren se Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj të datës 27.03.2007 është dashur vet të përcaktoj dënimin unik mbi bazën e dënimeve të veçanta të cilat i ka konfirmuar. Ajo është dashur të veproj kështu pavarësisht se e ka kthyer një pikë në rigjykim. Gjykata Supreme megjithatë nuk ka vepruar kështu prandaj ka shkaktuar konfuzion tek trupat gjykues të radhës dhe duke kërkuar në realitet nga ata të shqiptojnë një dënim unik të formës së prerë për veprat penale të cilat, në fakt, nuk i kanë gjykuar.

41. Trupi gjykues përmes aktgjykimit të kundërshtuar refuzoi akuzën lidhur me *Rrëmbim të dëshmitarit FY* që ishte ende në pritje lidhur me të dy të akuzuarit. Kjo pjesë e aktgjykimit të kundërshtuar është e pakontestueshme.

42. Trupi gjykues pastaj vazhdoi të shqiptoj një dënim unik sipas udhëzimeve të Gjykatës Supreme.

43. Para se ta bëjë këtë, trupi gjykues mori një vendim të konsideruar lidhur me ligjin penal substancial të aplikueshëm për një kalkulim të tillë (shih aktgjykimin e kundërshtuar, ff. 8-9).

44. Të akuzuarit janë dënuar dhe ndëshkimet janë shqiptuar në pajtueshmëri me KP RSFJ. Kodi penal në fuqi më 02.12.2011 kur trupi gjykues nxori aktgjykimin e kundërshtuar ishte Kodi Penal i Kosovës (KPK 2004). Trupi gjykues në pajtueshmëri me nenin 2 të KPK-së vlerësoi nëse KPK-ja i riu është ligj më i favorshëm për të akuzuarit. Nëse përgjigja do të ishte pozitive, trupi gjykues do të duhej të zbatonte KPK-në.

45. Trupi gjykues në mënyrë korrekte analizoi dispozitat relevante të të dy kodeve e edhe në mënyrë korrekte vërtetoi se KPK-ja *nuk* ishte më i favorshëm për të akuzuarit. Ky konkluzion kryesisht u bazua në krahasimin në mes të dy dënimeve maksimale që mund të shqiptohen nën KP RSFJ dhe nën KPK. Sipas aplikimit të KP RSFJ, dënimi unik nuk mund të kaloj 15 vjet (neni 48 paragrafi (2) nën paragrafi 3) i KP RSFJ), ndërsa sipas KPK-së, dënimi unik nuk mund të kaloj 20 vjet (neni 71 paragrafi (2) nën paragrafi 2) i KPK-së). Gjykata e Apelit vërteton gjetjen lidhur me ligjin e aplikueshëm në aktgjykimin e kundërshtuar.

46. Gjykata e Apelit vëren se pas nxjerrjes së aktvendimit të kundërshtuar, në territorin e Kosovës ka hyr në fuqi kodi penal i ri – Kodi Penal i Republikës së Kosovës, kodi nr. 04/L-082 (KPRK). Kodi parasheh parimin e zbatimit të ligjit më të favorshëm për të akuzuarin në rast se ligji ndryshon para se aktgjykimi të marr formën e prerë (neni 3 i KPRK).

47. Gjykata e Apelit prandaj është e obliguar të vlerësoj nëse kodi penal i Kosovës i riu është më i butë sa i përket llogaritjes së dënimit unik pra edhe të aplikohet ndaj të akuzuarit.

48. Gjykata e Apelit i referohet nenit 80 të KPRK i cili përcakton rregullat për llogaritjen e dënimeve unike kur i akuzuari shpallet fajtor për bashkim të veprave penale. Në pajtueshmëri me nenin 80 paragrafi (2) nën paragrafi 2.2) të KPRK që është i zbatueshëm në lëndën në fjalë "...

nëse për secilën prej veprave penale gjykata ka shqiptuar dënimin me burgim, dënimi unik duhet të jetë më i madh se çdo dënim i veçantë, por dënimi unik nuk mund të arrij shumën e të gjitha dënimeve të përcaktuara dhe as të tejkalojë periudhën prej njëzet e pesë (25) vjetësh”.

49. Gjykata e Apelit prandaj konstaton se dënimi maksimal i përcaktuar me KPRK është më i lartë (25 vjet) sesa me KPK dhe KP RSFJ – pra edhe në kuadër të kodit penal të ri në fuqi nga data 01.01.2013 ligji më i favorshëm për të akuzuarin në këtë lëndë mbetet KP RSFJ.

Arsyetimi lidhur me mos pranueshmërin e ankesës

50. Gjykata e Apelit hedh poshtë ankesat e mbrojtjes si të palejueshme pasi që ato orvaten të kundërshtojnë dënimet e të akuzuarit për veprat penale të *Rrëmbim* të dëshmitarëve 3 dhe 4, dhe për **Sh. M.** edhe për veprën penale të *Rrëmbim* i dëshmitarit AK dhe për veprën penale *Detyrim në tentativë*. Gjykata e Apelit njëherazi refuzon ankesat e mbrojtjes si të palejueshme në pjesën ku kundërshtojnë vërtetimin e dënimeve individuale për të akuzuarit për veprat penale të lartë përmendura – 8 vjet burgim për secilën pikë të *Rrëmbim* për të akuzuarin **Sh. M.**, 5 vjet burgim për secilën pikë të *Rrëmbim* për të akuzuarin **B. T.**, 2 vjet burgim për të akuzuarin **Sh. M.** për veprën penale *Detyrim në tentativë*.

51. Gjykata e Apelit përsërit se shpallja fajtor dhe dënimet individuale të shqiptuara tanimë janë vërtetuar përmes aktgjykimit të Gjykatës Supreme nr. AP 470/2004 të datës 27.03.2007 të përmirësuar përmes aktgjykimit korrigjues të datës 10.03.2010. Kjo pjesë e aktgjykimit të parë të datës 25.06.2004 prandaj është e formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet më me ankesë.

52. Po që se mbrojtja donë të kundërshtoj aktgjykimin e formës së prerë, këtë mund ta bëjë duke ushtruar mjet juridik të jashtëzakonshëm të përshtatshëm në Gjykatën Supreme.

Arsyetimi lidhur me refuzimin e arsyeve të ankesës

53. Aty ku ankesat kundërshtojnë llogaritjen e dënimin unik, sikurse është vërtetuar dhe shqiptuar përmes aktgjykimit të kundërshtuar, kjo pjesë e ankesave refuzohet si e pabazuar.

54. Gjykata e Apelit vëren se në pajtueshmëri me nenin 48 paragrafi (2) nën paragrafi 3) i KP RSFJ dënimi unik i shqiptuar duhet të kalojë dënimin më të rëndë të vlerësuar por nuk duhet të kalojë shumën e të gjitha dënimeve të përcaktuar apo 15 vjet burgim.

55. Trupi gjykues më tej ishte i obliguar me nenin 378 të aplikueshëm përmes nenit 390 paragrafi (4) LPP, me të ashtuquajturën ndalim i *reformation in peius*. Aktgjykimi i parë i datës 25.06.2004 si edhe aktgjykimi i lëshuar më 05.10.2010 ishin ankimuar vetëm nga mbrojtja prandaj çfarëdo vendimi i trupit gjykues nuk ka mundur të lëshohet në dëm të të akuzuarit në pikëpamje të sanksionet penal të shqiptuar aty. Duke pasur në konsideratë se dënimi unik në aktgjykimin nr. P 181/07 të datës 05.10.2010 ishte i caktuar me 10 vjet dhe 6 muaj për të akuzuarin **Sh. M.** dhe 6 vjet dhe 9 muaj për të akuzuarin **B. T.**, trupi gjykues ishte i kufizuar në këto dënime.

56. Trupi gjykues, sikurse është e dukshme nga arsyetimi i aktgjyimit të kundërshtuar, shikoi të kaluarën penal të të dy akuzuarve dhe raportet e hollësishme nga qendra e paraburgimit në Dubravë lidhur me sjelljen e të pandehurve derisa janë mbajtur në paraburgim.

57. Trupi gjykues mori parasysh edhe çështjet e tjera të tilla si rëndësia e veprave penale, koha e kaluar nga kryerja e tyre, faktin se tani aktakuza e ndryshuar (tërheqja e akuzave lidhur me rrëmbimin e dëshmitarit FY) përmban një pikë më pak si edhe sjelljen e kaluar dhe të tanishme (të mirë) të të akuzuarve. Trupi gjykues në kuadër të këtyre konsideratave dhe duke pasur parasysh dënimet individuale tanimë të shqiptuara të formës së prerë, caktoi dënimin unik për **Sh. M.** me 9 vjet burgim dhe për **B. T.** me 6 vjet dhe 9 muaj burgim. Edhe kohën të cilën të akuzuarit e kaluan në paraburgim, trupi gjykues ua llogariti në dënimin e tyre.

58. Gjykata e Apelit nuk gjen asnjë të metë faktike apo ligjore në këtë vlerësim të trupit gjykues. Njëherazi trupi gjykues në mënyrë të duhur dhe të mjaftueshme arsyetoi vendimin e tij. Gjykata e Apelit i referohet këtij arsyetimi për të shmangur përsëritjen.

59. Gjykata e Apelit prandaj konfirmon dënimin unik të shqiptuar ndaj të dy të akuzuarve.

60. Gjykata e Apelit në pajtueshmëri me nenin 376 të LPP-së bëri edhe një shqyrtim *ex officio* të aktvendimit të kundërshtuar dhe nuk gjeti asnjë shkelje me dispozitën e përmendur.

61. Në kuadër të kësaj që u tha më lart, Gjykata e Apelit pjesërisht hedh poshtë si të palejueshme ankesat e të akuzuarve **Sh. M.** dhe **B. T.** aty ku ankesat kundërshtojnë dënimin dhe shqiptimin e dënimeve të veçanta ndaj të akuzuarve. Në pjesën e mbetur, Gjykata e Apelit refuzon të dy

ankesat si të pabazuara dhe vërteton aktgjykimin e kundërshtuar. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit bazohet në nenet 383 dhe 384 të LPP-së.

62. Prandaj u vendos si në dispozitiv.

Përgatitur në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar.

Kryetarja e kolegjit

Hajnalka Veronika Karpati

Gjyqtare e EULEX-it

Anëtari i kolegjit

Anëtari i kolegjit

Fillim Skoro

Xhevdet Abazi

Gjyqtar

Gjyqtar

Procesmbajtësja

Beti Hohler

Zyrtare ligjore e EULEX-it

Aktgjykimi i arsyetuar është kompletuar më 8.07.2013

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Pakr 907/12

30 prill 2013